




# PROJEKTI SEMP - ENERCOACH


## SEMP prezanton softuerin e kontabilitetit të energjisë EnerCoach në Shqipëri

### Çfarë është EnerCoach?

Projekti i Bashkive me Përdorim Inteligent të Energjisë (SEMP) po prezanton programin kompjuterik **EnerCoach** për bashkitë shqiptare. **Enercoach** është një programin kompjuterik për menaxhimin e performancës energjitiqe i zhvilluar nga kompania zvicerane ECOSPEED. Ky programin kompjuterik është i lehtë për t'u përdorur, efektiv dhe u mundëson bashkive të mbledhin, menaxhojnë dhe analizojnë të gjitha të dhënat përkatëse të konsumit të komoditeteve të energjisë (përfshirë komoditetet energjetike për ngrohje, energjinë elektrike nga ndërtesat dhe shërbimet e tjera bashkiake), si dhe emetimet e CO<sub>2</sub> në nivel bashkiak dhe ndriçimin publik



### Përshtatur me nevojat shqiptare



Në bashkëpunim me ECOSPEED, SEMP e përshtati **EnerCoach** në kontekstin lokal. Platforma është e përkthyer në gjuhën shqipe dhe futja e të dhënave është përshtatur me kontekstin lokal. Aplikacioni ofron vlerën bazë të një ndërtese duke marrë parasysh karakteristikat e saj dhe zonën klimatike, si dhe konsumin e synuar pas rinovimit. Kjo lejon që të kuptohet më mirë stoku i ndërtesave bashkiake dhe të udhëzohet planifikimi i investimeve dhe prioritizimi i ndërtesave.

## Si funksionon EnerCoach?

Çdo bashki, në të cilën Projekti SEMP është aktiv, i jepet akses në aplikacionin EnerCoach i ruajtur online. Të gjitha ndërtesat bashkiake përfshihen në **inventar** duke përfshirë informacionin për vendndodhjen, sipërfaqen, llojin e ndërtesës dhe karakteristikat e saj, si p.sh. shërbimet dhe teknologjitë. Më pas përfshihen të dhënat për **konsumin real të energjisë** për tre vitet e fundit si dhe vazhdojnë të shtohen në bazë vjetore duke lehtësuar raportimin e rregullt.

The screenshot displays the EnerCoach web application interface. At the top, there's a navigation bar with 'EnerCoach' and various menu items like 'PANELI I KONTROLLEVE', 'BILANCI', 'INFORMACION PER KOMPANINE', 'LLOGARIA', 'SQ', and 'Ndihmë dhe suport'. Below this, there's a search bar and filters for 'Viti i bilancit' (2019) and 'Hapësira kohore' (2019-2025). The main interface is divided into a sidebar on the left with a tree view of buildings, a central area with a building photo and details for 'Godina Rajoni nr.3', and a right-hand panel with energy consumption data. The data includes 'Konsumi (duke përfshirë energjinë elektrike për ngrohje)' at 3'169.00 kWh, 'Ngrohja nga energjia elektrike' at 2'535.00 kWh, and a total consumption of 470 m³.

EnerCoach tregon gjendjen energjetike të ndërtesave dhe mënyrën se si konsumi, emetimet dhe kostot si dhe variacionet e tyre ndryshojnë me kalimin e kohës. Njëkohësisht mundëson planifikimin e masave të rinovimit të ndërtesave publike dhe monitorimin pasues të kursimeve të energjisë pas rinovimit.

## Cilat janë përfitimet e EnerCoach?

- I përshtatur për nevojat lokale dhe programin kompjuterik i konsoliduar për monitorimin e performancës së ndërtesave publike dhe ndriçimit rrugor.
- Bazë për planifikim më të mirë dhe akses në financim.
- Menaxhon koston e energjisë duke mundësuar kursime në buxhetin bashkiak.
- Programi kompjuterik raportimi për Këshillin Bashkiak në nivel bashkiak, Agjencinë për Eficiencën e Energjisë në nivel vendi.
- Ofrohet online ka mbështetje dhe bashkëpunim dhe nga konsulentë ndërkombëtarë.
- Lejon sigurimin e cilësisë dhe kalibrimin e të dhënave.
- Ofron një bazë të mirë për konceptet e rinovimit përfshirë, lehtësime për shpenzimet.
- Monitoron rezultatet e masave të kursimit të energjisë.

## Çfarë është Projekti i Bashkive të Energjisë së Zgjuar (SEMP)?

SEMP është një projekt i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe i Agjencisë Kombëtare të Eficiencës së Energjisë (AEE) i mbështetur nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO

